

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri 31.06.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 107, datë 09.09.2014.

Në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 556/11, datë 09.09.2014, dërguar znj. Kamelia Vojka, Titullare e Institucionit në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Nga auditimi i dokumentacionit në DSHQ, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e kaluara, rezulton se një pjesë e tyre nuk janë zbatuar. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të analizojë dhe njëherë materialin e auditimit e rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe të ndjekë hapat ligjorë për realizimin e tyre, duke vënë para përgjegjësisë personat e ngarkuar nga titullari i institucionit.

Menjëherë.

2-Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të mare masa që Drejtoria e Njësisë së Buxhetit, Raportimit Statistikor dhe Financave dhe Drejtoria Juridike, të ndjekin dhe të evidentojnë, dhe të rakordojnë arkëtimin e të gjitha detyrimeve duke analizuar gjendjen e detyrimeve sipas llogarive dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mosarkëtimin e tyre në kohë që rezultojnë gjendje në Bilancin Përmbledhës datë 31.12.2013 të DSHQ-së dhe të Bilancit të Degës së Shërbimeve Qeveritare Durrës sipas dispozitave ligjore në fuqi, pasi në DSHQ dhe DSHQ Durrës, u konstatua gjendje e detyrimeve debitoare të pa arkëtuara në bilancin e tyre

Menjëherë.

3-Institucioni në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, të përfundojë identifikimin e të gjithë aseteve që janë në kontabilitet por nuk janë fizikisht e më pas sistemimin e tyre në kontabilitet.

Ne vazhdimesi

4-Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare, të bëjë një vendim të kujdesshëm në lidhje me trajtimin e 9 autoveturave gjendje në parkun e delegacioneve prodhime të viteve 1974, 1978 me vlerë totale prej 10 100 mijë lekë bazuar në një mendim specialistësh duke pasur parasysh vlerën relike të tyre nëse do të shiten me ankand të 9 automjeteve duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Menjëherë.

5-Institucioni të marrë masa të menjëhershme për evidentimin e saktë të aktiveve në pronësi duke i saktësuar me të dhënat në kontabilitet, rregjistrimin e të gjithë pasurisë së paluajtshme në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe kërkesat e UMF nr.30, datë 27.12.2011.

Ne vazhdimesi.

6-Institucioni të marrë masat e duhura që të përfundojë vlerësimin dhe regjistrimin në kontabilitet e të gjitha objekteve pasuri e paluajtshme , si dhe hipotekimin e tyre në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “ Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme “, i ndryshuar, bazuar dhe në VKM nr.1058, datë 16.07.2008.

Ne vazhdimesi.

7-DSHQ të përfundojë inventarizimin fizik të saj duke saktësuar të dhënat e saj me ato të inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara të zbatojë kërkesat e UMF nr. 30 , datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” duke e shoqëruar dhe me një analizë ku të dalin dhe përgjegjësitë për personat që i kanë në ngarkim.

Menjëherë.

8- DSHQ në bashkëpunim me Degën e DSHQ Durrës në ngritjen e komisioneve të inventarizimit të zbatojë me korrektesë kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82

Menjëherë.

9- Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të marrë masat e duhura që Blerjet me vlera të vogla të kryhen sipas rregullave të prokurimit, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, germa “a”, pa pjesëtuar vlerën e kontratës, për të mos shmangur procedurat konkurruese të prokurimit.

Menjëherë.

10 - Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të marrë masat që:

- Regjistrimi i prokurimeve të hartohet dhe plotësohet për të gjitha shpenzimet, investimet e shërbimet që planifikohen të kryhen dhe janë kryer deri në fund të vitit ushtrimorë.

- Të zbatohet legjislacioni i prokurimeve për blerjet me vlerë të vogla, duke filluar që nga nxjerrja e Urdhër Prokurimit për blerjet me vlera të vogla deri tek dokumentacioni shoqëruar i faturës tatimore dhe hyrjet në magazinë

- Të gjitha faturave tatimore duhet ti bashkëngjiten dokumentacionet ligjore origjinale ose të noterizuara dhe jo të fotokopjuara.

- Të mos shmangen për asnjë arsye procedura e prokurimit të blerje me vlerë të vogël për punë mallra e shërbime, pa pasur argumentim bindës dhe ligjorë.

- Të planifikohen nevojat reale për mallra e shërbime, në menyrë që të mos perdoren procedurat e prokurimit për raste emergjente, duke copëzuar fondet e vena në dispozicion dhe duke ju shmangur konkurrencës reale dhe formave efektive të prokurimeve si ato të përqendruar.

Menjëherë.

11- DSHQ të marrë masat që të zbatojë kërkesat e nenit 18 të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, duke plotësuar, Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në koordinim me njësinë publike nga e cili varet.

Menjëherë.

12. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të mare masat që në zbatim të kërkesave të nenit 8/a, 10, 11 dhe 21 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar” dhe kontrollin”, të hartojë regjistrin e risqeve.

Menjëherë.

13- Institucioni në Rregulloren e brendshme të rindërtojë Organigramën e Organizimit dhe Funksionimit të DSHQ-së ballafaquar me kërkesat dhe përgjegjësitë e kreut II, neni 8 “Përgjegjëshmëria menaxheriale e titullarit” të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku përcaktohet se titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë si detyrim *“Miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë së tyre; Kjo strukturë duhet rishikuar, harmonizuar, përputhur dhe plotësuar duke rivendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion në administratën e DSHQ-së, me qëllim që të ofrohet siguria e duhur se aktivitetet operative dhe administrative të funksionojnë në pajtim me standardet e mira dhe objektivat strategjike të institucionit.*

Menjëherë.

14- Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare Tiranë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të mare masa për nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre mallrave dhe materiale stok në vlerë 2 938 006 lekë gjendje në magazinat e Institucionit të cilët kanë humbur cilësinë dhe vlerën e përdorimit dhe që ndodhen gjendje në fund të vitit 2013, pasi më parë të kryejë vlerësimin dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë.

15. DSHQ të mare masat që të ngrejë një grup pune për të verifikuar të gjitha listë prezencat (dokumentacionet që disponohen për hyrjen dhe daljen e punonjësve të vilave rezidenciale) që administrohen nga DSHQ për periudhën Janar – Dhjetorë 2013, të ballafaqohen me listë-prezencat dhe listë-pagesat e depozituara në sektorin e financës, të nxirret vlera e paguar më tepër për punonjësit e vilave rezidenciale të DSHQ për këtë periudhë dhe të marrë masa për kthimin e këtyre shumave në buxhet.

Menjëherë.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 e nenin 171 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”,

1.Për znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e juristes së institucionit, për shkeljet e konstatuara

-Për mos zbatimin të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar të kontrollit, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH-së në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 70, datë 18/4/2006 “Për masat në zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në institucionet e vartësisë të Kryeministrit a të Ministrive”.

2.Për znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e Drejtores së Njesisë së Buxhetit, Raportimit Financiar dhe Financave për shkeljet e konstatuara:

-Në blerjet e vogla të organizuara në kundërshtim me gërma b), pika 1, me kreu II, gërma a), pika 1, me kreu IV, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Udhëzimit Nr.2, datë 28.03.2013, Udhëzimet Nr.7, datë 20.12.2012 dhe Udhëzimi Nr.4, datë 04.07.2013,

-Për mos zbatimin të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar të kontrollit, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH-së në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 70, datë 18/4/2006 “Për masat në zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në institucionet e vartësisë të Kryeministrit a të Ministrive”.

3.Për znj. [REDAKTUAR] me detyrë ish Drejtore e financës së DSHQ nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi është i larguar nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT